

AKTI I THEMELIMIT
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“PureHerb” shpk

- 1) Sot, më 29/10/2025, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **“PureHerb” SHPK.**
- 2) Themeluesit e shoqërisë janë:
Z. Muhamed Hoxha, shtetas Shqiptar, identifikuar me letërnjoftim me nr. 035179809 dhe me nr. ID J60716020P i datëlindjes 16.07.1996 lindur në Berat dhe banues në Fier, Rruga Elefteri Kapo, sheq i madh, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas kushteve të mëposhtëme.

Neni 1
Themelimi

- 1) Emri i shoqërisë është **“PureHerb” shpk.**
- 2) Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 3) Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 2:
Objekti

- Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë ushtrimin e aktiviteteve në fushën e ofrimit të shërbimeve të lavanderisë, pastrimit kimik, tharjes dhe hekurosjes së rrobave, tekstileve, tapeteve dhe produkteve të ngjashme. Shoqëria do të merret gjithashtu me tregtimin me pakicë dhe shumicë të bimëve medicinale, produkteve bimore, çajrave natyralë, vajrave esenciale, produkteve kozmetike natyrale dhe artikujve higjieno-sanitare. Ajo mund të kryejë veprimtari për përpunimin, paketimin dhe shpërndarjen e produkteve bimore medicinale sipas legjislacionit në fuqi, si dhe të ushtrojë aktivitetin e importit dhe eksportit të mallrave të ndryshme që lidhen me fushën e veprimtarisë. Shoqëria mund të krijojë dhe administrojë pika shitjeje, dyqane, depo, si dhe të zhvillojë aktivitete promovuese dhe marketingu. Ajo mund të ushtrojë çdo aktivitet tjetër tregtar, industrial apo shërbim tjetër të ligjshëm që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me qëllimin e saj.

Neni 3:
Kohëzgjatja

- 1) Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

Neni 4:
Selia

- 1) Shoqëria e ka selinë në: Fier, Rruga Kastriot Muço, Zona Kadastrale 8533, Nr. Pasurie 5/49,9305
- 2) Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

Neni 5
Kapitali themeltar

- 1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100,000 (Njëqind mijë) Lekë dhe është i përbërë nga 1 (një) kuotë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:



A. Ortakët themelues:

- **Z. Muhamed Hoxha**, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100,000 (Njëqind mijë) Lekë, që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

- 2) Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Neni 6

Organi Vendimmarrës

- 1) Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
- 2) Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj

Neni 7

Administratori

- 1) Administratorë të shoqërisë emërohet :
Z. Muhamed Hoxha , shtetas Shqiptar, identifikuar me letërnjoftim me nr. 035179809 , i datëlindjes 16.07.1996 lindur në Berat dhe banues në Fier,Rruga Elefteri Kapo, sheq i madh, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Neni 8

Baza Ligjore

- 1) Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelim dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 2) Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelim, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë

Neni 9

Mosmarrëveshjet

- 1) Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njohura nga ligji.

O R T A K E T
E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“PureHerb” SHPK

Z. Muhamed Hoxha